



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.10.2025
Numër Protokolli: 6997/2025

A.nr.1697/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar në çështjen juridike administrative sipas ankesës me numër A.nr.1697/2025, të datës 15.09.2025, të parashtruar nga ankuesja, N.B-H nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike ‘kontestim konkursi’, në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.1697/2025, të datës 15.09.2025, të parashtruar nga ankuesja, N.B-H.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, N.B-H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 15.09.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli Nr.6143/2025, të regjistruar nën shenjë A.nr.1697/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 12.09.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, për refuzimin e aplikacionit të datës 09.09.2025, në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00018633, për pozitën Zyrtar të Trajnimit në KKZ në Zveçan, të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa, e njëjta më datë 21.10.2025, përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmsheq@rks-gov.net ka parashtruar kërkesë e për tërheqje të ankesës me numër A.nr.1697/2025 të datës 15.09.2025, e protokolluar në Këshill me numër protokolli 6922/2025, me arsyetimin se ankuesja ka themeluar marrëdhënien e punës në Komisionin Qendror i Zgjedhjeve në pozitën, Zyrtar i Trajnimit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, vendosi për përfundimin e procedimit

administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1697/2025, të datës 15.09.2025, pasi që nga kërkesa e datës 21.10.2025, rezulton se ankuesja nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.1697/2025, datë 24/10/2025

Kaltrina AVDULLAHI-PRENAJ

Arben MEHMETI

Procesmbajtëse

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, N.B-H;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.